



Breaking News:

Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, gjatë 24 orëve të fundit



10/04/2025

# Tiranë – Policia Identifikon Dhe Shpall Në Kërkim Një 32-Vjeçar Që Plagosi Me Armë Zjarri Një Shtetas, Mbrëmjen E Djeshme, Gjatë Një Konflikti Për Motive Të Dobëta

Tiranë

Policia identifikon dhe shpall në kërkim një 32-vjeçar që plagosi me armë zjarri një shtetas, mbrëmjen e djeshme, gjatë një konflikti për motive të dobëta.

Specialistët e Sektorit për Krimet e Rënda, në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 4, pas marrjes së njoftimit, mbrëmjen e djeshme, se në Rrugën e Dibrës ishte plagosur me armë zjarri një shtetas, kanë shkuar menjëherë në vendin e ngjarjes.

Si rezultat i veprimeve të shpejta hetimore, u identifikua dhe u shpall në kërkim shtetasi F. C., 32 vjeç, i cili dyshohet se, gjatë një konflikti për motive të dobëta me shtetasin G. H., 29 vjeç, e ka qëlluar këtë të fundit në këmbë, me armë zjarri.

Shtetasi G. H. mori ndihmë mjekësore dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

Vijojnë veprimet intensive për lokalizimin dhe kapjen e autorit, si dhe për dokumentimin e plotë ligjor të kësaj ngjarjeje.

◀ Drejtoria Vendore e Policisë Berat, gjatë 24 orëve të fundit

DVP Vlorë – Finalizohet operacioni i koduar “Nightfall 2 ”, goditet një rast i armëmbajtjes pa leje ▶

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)